

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6778
E premte, 9 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

Shtetit i zhduken mostrat e Astrit Deharit nga laboratori I FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SITUATA E SIGURISË VË NË PIKËPYETJE ZGJEDHJET NË VERI I FAQE 4-5

HARADINAJ: KURTI PO E SHTYN NJË AUTONOMI PËR VERIUN, TË JAPË DORËHEQJE



Ish-kryeministri dhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kryeministri Albin Kurti do që t'i mbajë zgjedhjet në veri me çdo kusht si pjesë e "një skenari që i jep autonomi veriut". Ai ka thënë se Kurtit nuk po i mjafton

asociacioni të cilin tashmë e ka bërë akt të kryer. Lideri i AAK-së ka kërkuar nga Kurti të japë dorëheqje. Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile që monitorojnë zgjedhjet në Kosovë, procesi në veri duhet të shtyhet për një afat të pacaktuar

AKTUALE



KURTI DHE VUÇIQI JANË FTUAR
NË BRUKSEL, DATA S'DIHET F. 3

KDI: ZERO RASTE TË SINJALIZIMIT
BRENDA INSTITUCIONEVE
TË DREJTËSISË F. 5

PARALAJMËROHET RRRITJE E
ÇMIMIT EDHE PËR GRUMBULLIMIN
E BËRLLOKUT F. 7

EKONOMI



KUVENDI MIRATON VAZHDIMIN E
MASAVE EMERGJENTE PËR ENERJJI F. 8

DEL NË KONSULTIM PUBLIK LIGJI
PËR BURIMET E RIPËRTËRISHME TË
ENERGJISË F. 8

SPORT



SOT ZHVILLOHEN ÇEREKFINALET
E PARA KROACI - BRAZIL DHE
HOLANDË - ARGJENTINË F. 10



222 ZYRTARË
PUBLIKË, TË
PUNËSUAR NË
POZITA TË LARTA
PUBLIKE, KANË
LIDHJE ME
PARTITË I FAQE 3

KOSOVA PËRFITON
GRANTE NGA KORNIZA
INVESTUESE E BALLKANIT
PERËNDIMOR NË VLERË PREJ
57.6 MILIONË EUROSHI I FAQE 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Putini: Rreziku bërthamor po rritet, por ne nuk jemi çmendur

MOSKË, 8 DHJETOR - Presidenti rus Vladimir Putin ka thënë se kërcënimi i një lufte bërthamore është duke u rritur, mirëpo ka insistuar se Rusia "nuk është çmendur" dhe nuk do ta përdorë e para armën bërthamore. Sipas Putinit, Rusia do ta përdorë armën e shkatërrimit në masë vetëm si kundërpërgjigje ndaj një sulmi. Duke folur në takimin e Këshillit rus për të Drejtat e Njeriut, ai ka thënë se lufta në Ukrainë mund të jetë "proces i gjatë".

Zyrtarët perëndimorë besojnë se Putini fillimisht ka planifikuar fitore të shpejtë në konfliktin e nisur në Ukrainë në fund të muajit shkurt.

Kapaciteti i Rusisë për të përdorur armë bërthamore ka shqetësuar shumë liderë botërorë prej nisjes së luftës. "Një kërcënim i tillë po rritet. Është gabim nëse e fshehim", ka paralajmëruar Putini derisa ka folur për luftën përmes videolidhjes.

Putini ka pretenduar se Rusia e ka armën më moderne dhe më të avancuar bërthamore në botë dhe ka kritikuar strategjinë

bërthamore amerikane. "Ne nuk kemi armë bërthamore, përfshirë ato taktike, në territorin e shteteve të tjera, mirëpo amerikanët kanë - në Turqi dhe disa vende të tjera të Evropës".

Putini ka përmendur ato që i ka konsideruar rezultate "të mëdha" në luftën në Ukrainë, duke përmendur pretendimet e Rusisë për aneksim të katër rajoneve në Ukrainë pas mbajtjes së referendumëve të rreme. Ai ka thënë se aneksimet e kanë bërë Detin Azov, një "det të brendshëm", dhe se ky ka qenë synimi i Petrit të Madh të Rusisë. Putini edhe më parë e ka krahasuar veten me këtë udhëheqës të shekullit 17 dhe 18. Por, pavarësisht prej pretendimeve për këto katër territore - Herson, Zaporizhja, Luhansk dhe Donjeck - Moska nuk ka kontroll të plotë mbi to. Muajin e kaluar forcat ruse janë tërhequr nga qyteti i Hersonit, njëherësh qyteti i vetëm i madh që e ka kontrolluar që prej shpërthimit të luftës.

Zmbrapsjet në fushëbetë kanë nxitur Rusinë që ta bombardojë



infrastrukturën ukrainase të energjisë, duke lënë miliona njerëz pa rrymë dhe ujë, teksa temperaturat kanë arritur nën zero.

Kryetari i qytetit të Kievit, Vitali Klitschko, ka paralajmëruar se kryeqyteti ukrainas është

dëmtuar rëndë nga këto sulme dhe se qytetarët mund të përballen me "apokalips".

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.

Presidenti Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Talibanët rikthejnë ekzekutimet në publik

KABUL, 8 DHJETOR - Administrata talibane e Afganistanit ka dënuar me vdekje një person, duke e ekzekutuar në publik. Ky është ekzekutimi i parë në publik që kur grupi militant rimori pushtetin në Afganistan në gushtin e kaluar.

Zëdhënësi i talibanëve, Zabihullah Mujahid, tha më 7 dhjetor se zyrtarët e lartë të grupit morën pjesë në ekzekutimin e një burri nga qarku Injil në provincën Herat. Ai pretendohet se ka pranuar se ka vrarë një person me thikë dhe i ka vjedhur motoçikletën dhe telefonin gjatë një grabitjeje pesë vjet më parë.

Disa zyrtarët të lartë talibanë, përfshirë edhe zëvendëskryeministrin Abdul Ghani Baradar, ishin të pranishëm gjatë ekzekutimit, tha zëdhënësi i qeverisë, Bilal Karimi. Përveç Baradarit, i pranishëm ishte edhe ministri i Brendshëm, Sirajuddin



Haqqani, dhe udhëheqësit e gjyqësorit dhe dikastereve të tjera qeveritare.

Agjencia e lajmeve "Reuters" tha se ekzekutimi u krye në pjesën

perëndimore të Afganistanit. Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, ka shprehur "shqetësim të thellë" lidhur me ekzekutimin në publik,

tha zëdhënësjja e tij, Stephanie Tremblay. "Qëndrimi ynë nuk ka ndryshuar. OKB-ja është kundër dënimit me vdekje", tha ajo dhe shtoi se OKB-ja bën thirrje për

rikthimin e moratoriumit për dënime me vdekje në Afganistan. Talibanët morën kontrollin e Afganistanit gushtin e kaluar, në kohën kur trupat ndërkombëtare u tërhoqën nga shteti pas dy dekadash.

Grupi militant ka kufizuar të drejtat e grave dhe vajzave sa i përket punës dhe arsimimit.

Shumica e shteteve të botës nuk e njohin qeverinë e udhëhequr nga talibanët për shkak të shqetësimeve se militantët nuk do t'u përmbahen premtimeve për t'i respektuar të drejtat e njeriut. Megjithatë, më 17 mars Këshilli i Sigurimit i OKB-së votoi për të krijuar lidhje zyrtare me Afganistanin.

Dënime me vdekje janë zbatuar gjatë regjimit të mëhershëm taliban nga viti 1996-2001, periudhë kur ekzekutimet dhe ndëshkimet kryeshin para turmave të mëdha.

OBSH-ja synon marrëveshje globale për luftim të pandemive

Gjenevë, 8 dhjetor - Organizata Botërore e Shëndetësisë ka njoftuar se në shkurt të vitit të ardhshëm do t'i nisë negociatat për një marrëveshje globale, që synon luftim më të mirë të pandemive.

Organizata me 194 vende anëtare ka thënë se një

marrëveshje e tillë është e nevojshme për të siguruar që të mos përsëritet më kurrë kriza globale e shkaktuar nga pandemia e koronavirusit.

Në negociatat e zhvilluara këtë javë është thënë se shtetet janë pajtuar "për ta zhvilluar draftin e parë të marrëveshjes, që synon

mbrojtjen e botës nga pandemitë në të ardhmen".

Ky njoftim vjen disa ditë para përvjetorit të tretë të shpërthimit të koronavirusit në Kinë. Disa javë më vonë virusi ka nisur të përhapet në gjithë botën, duke shkaktuar pandeminë më të rëndë në shekull.



Kurti dhe Vuçiqi janë ftuar në Bruksel, data s'dihet ende

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian (BE), Josep Borrell, e ka ftuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në takim në Bruksel.

Lajmin e ka bërë me dije të enjten zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, në një konferencë për medie. Ai ka thënë se data e takimit ende nuk dihet. "Disa herë kemi thënë se do të ketë takim

mes presidentit Vuçiq dhe kryeministrit Kurti. Përfaqësuesi i lartë, Josep Borrell, i ka ftuar ata të vijin në Bruksel. Do të japim datën e saktë kur të jetë e caktuar", ka thënë Stano.



222 zyrtarë publikë, të punësuar në pozita të larta publike, kanë lidhje me partitë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Organizata "Çohu", në kuadër të Javës Kundër Korrupsionit, ka publikuar hulumtimin "Zaptimi i vazhdueshëm", ku janë paraqitur gjetjet se në sa prej pozitave të larta publike janë punësuar persona përmes konkurseve publike e të cilët kanë lidhje me partitë politike. Hulumtimi ka përfshirë periudhën 2017-2021. Të dhënat tregojnë se në këtë periudhë kohore, 222 zyrtarë publikë që janë të punësuar në pozita të larta publike kanë lidhje me partitë politike.

Pjesë e hulumtimit dhe verifikimit kanë qenë të gjithë zyrtarët e lartë publikë të cilët e deklarojnë pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK). Të dhënat tregojnë se varësisht se cila parti është në pushtet, e shfrytëzon mundësinë për shtrirjen e patronazhit politik në institucionet shtetërore. Kjo është faktuar edhe në dy hulumtimet paraprake që janë realizuar lidhur me këtë dukuri. Në 24 ndërmarrje publike janë verifikuar të gjithë zyrtarët që e deklarojnë pasurinë dhe të dhënat e siguruar tregojnë se 105 zyrtarë të lartë kanë lidhje me partitë politike.

Nga hulumtimi ka rezultuar se në periudhën 2017-2021 me punësime në ndërmarrjet publike prijnë LDK-ja dhe PDK-ja me nga 30, AAK-ja me 18, Nisma me 12, PSD-ja me 3, AKR-ja me 2, LV-ja me 5, si dhe SKS-ja, PShDK-ja, PD-ja, PLE-ja dhe KDTP-ja me nga një. Pjesë e hulumtimit kanë qenë edhe institucionet e pavarura dhe, sipas të dhënave, 19 persona që kanë lidhje me partitë politike, janë punësuar në pozita të rëndësishme vendimmarrëse në këto institucione. Numrin më të madh të të punësuarve përmes konkursit në institucione publike e ka PDK-ja me 7 zyrtarë, pasuar

nga LDK-ja me 6, AAK-ja ka 4 të tillë dhe nga një Nisma dhe AKR-ja. Edhe në ministri numri i zyrtarëve të lartë që janë përzgjedhur përmes konkurseve publike, e që kanë lidhje me partitë politike, është shumë i lartë. Hulumtimi ka gjetur se 96 zyrtarë të lartë që punojnë në ministri kanë lidhje me parti politike, prej tyre 38 janë nga PDK-ja, 17 nga LDK-ja, 16 nga AAK-ja, 10 nga AKR-ja, 7 nga Nisma, 2 nga LV-ja, 1 nga PSD-ja, 1 nga PD-ja, 2 nga Partia Demokratike Turke, 1 nga NDS-ja. Në këtë raport janë përfshirë edhe disa hulumtime të

realizuara nga "Çohu" ndër vite lidhur me politizimin e universiteteve publike. Në hulumtimin e realizuar në vitin 2016, rezultoi se 70 profesorë të UP-së kanë qenë apo ende janë pjesë e politikës njëkohësisht. Ndërkaq, përgjatë viteve 2017-2021, "Preportr" ka identifikuar 10 profesorë që u janë bashkuar partive politike. Në universitetet e tjera publike, atë të Prizrenit, të Pejës, të Gjilanit, të Gjakovës, të Mitrovicës dhe të Ferizajt, "Preportr" ka gjetur se në periudhën 2017-2021 në pozitave udhëheqëse në këto universitete janë përzgjedhur nëntë persona me prapavijë partiake.

Kuvendi miraton vazhdimin e masave emergjente për energji

Prishtinë, 8 dhjetor - Kuvendi i Kosovës ka miratuar vazhdimin e masave emergjente për furnizimin me

energji edhe për 30 ditë. Për vazhdimin e këtyre masave kanë votuar 61 deputetë. Opozita s'ka marrë pjesë në

votim. Në seancën e jashtëzakonshme opozita pati kritika dhe akuza për qeverinë dhe KEK-un për, siç theksoi, në

dështimin e mbajtjes në funksion të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike.





SITUATA E SIGURISË VË NË PIKËPYETJE ZGJEDHJET NË VERI

Haradinaj: Kurti po e shtyn një autonomi për veriun, të japë dorëheqje

Ish-kryeministri dhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kryeministri Albin Kurti do që t'i mbajë zgjedhjet në veri me çdo kusht si pjesë e "një skenari që i jep autonomi veriut". Ai ka thënë se Kurtit nuk po i mjafton asociacioni të cilin tashmë e ka bërë akt të kryer. Lideri i AAK-së ka kërkuar nga Kurti të japë dorëheqje. Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile që monitorojnë zgjedhjet në Kosovë, procesi në veri duhet të shtyhet për një afat të pacaktuar

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Incidentet e 6 dhjetorit në veri të Kosovës ngritën pikëpyetje për mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve në Mitrovicë të Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok më 18 dhjetor. Presidenca dhe Qeveria e Kosovës thanë se janë në pritje të vlerësimit të situatës së sigurisë nga Policia e Kosovës.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka theksuar se nuk ka kushte për një proces të tillë.

Zgjedhjet "nuk mund të mbahen me zor", ka deklaruar edhe kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi.

Ish-kryeministri dhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë të enjten se kryeministri Albin Kurti është duke bërë veprime antikombëtare dhe antishtetërore në raport me situatën e krijuar në veri.

Ai ka thënë se Kurti po e shtyn një autonomi për veriun.

Haradinaj ka kërkuar dorëheqjen e Kurtit. "E dhimbshme. E rrezikshme. Anti-kombëtare e anti-shtetërore krejt çka po bën e si po vepron kryeministri. Atij nuk po i mjafton asociacioni të cilin tashmë e ka bërë akt të kryer, por po e shtyn një autonomi për veri. Insistimi me çdo kusht i mbajtjes së zgjedhjeve në veri, është pjesë e

këtij skenari e jo nevojë për rikthim, as të ligjit e as të demokracisë në këtë pjesë të Kosovës. Por ky skenar 'nuk do te kalojë' as nga Kurti e as nga sejmënët e tij! Ky njeri e ka shansin e fundit ta bëjë një punë të mirë për Kosovë. Të japë dorëheqje!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ndërkaq Lidhja Demokratike e Kosovës ka theksuar se po ndjek me shqetësim të thellë ngjarjet e fundit në veri të vendit, sulmet ndaj institucioneve dhe ndaj rendit kushtetues të Republikës. "LDK-ja vlerëson se në këto momente është e domosdoshme që institucionet e Kosovës t'i koordinojnë të gjitha veprimet me partnerët tanë me qëllim të ofrimit të sigurisë për të gjithë qytetarët e vendit dhe institucionet e pavarura. Qetësia, siguria dhe ushtrimi i sovranitetit në tërë territorin e vendit nuk kanë alternativë. LDK-ja kërkon nga qeveria qartësi dhe plan konkret për gjendjen në veri", është thënë në reagimin e LDK-së.

Edhe të mërkurën në mbrëmje dy shok-bomba janë hedhur në Lagjen e Boshnjakëve dhe Kodrën e Minatorëve në veri të

Mitrovicës.

Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka thënë se pas këtyre zhvillimeve janë në koordinim të plotë me banorët dhe institucionet e sigurisë në veri të qytetit. "Jemi në koordinim edhe me pjesën tjetër të qytetit, si dhe banorët që jetojnë atje, edhe me organet e rendit dhe sigurisë. Informatat e deritanishme jua japin organet e sigurisë, pasi që janë më të sakta dhe janë përgjegjëse për këtë punë. Është mirë që të gjithë ta investojmë maksimumin tonë brenda kapaciteteve tona që të ruhen rendi, qetësia dhe stabiliteti dhe njerëzit të jetojnë të qetë në shtëpitë dhe pronat e tyre", ka thënë Hamza për "Gazetën10".

Komandanti i trupave të KFOR-it, Angelo Michele Ristuccia, ka deklaruar se ngjarjet e fundit në Mitrovicën veriore janë brengosëse sidomos në prag të zgjedhjeve. Ai ka thënë se e gjithë puna që është bërë ndër vite në veri rrezikon të humbet, derisa është shprehur këmbëngulës se nuk do ta tolerojnë dhunën në veri të vendit.

"Detyra jonë e parë është sigurimi i lëvizjes së lirë në

Kosovë. Jemi të pajisur për t'u ballafaquar me një situatë të tillë, por ne veprojmë në pajtim me situatën në mënyrën më të mirë të mundshme, duke reaguar ndaj cilësdo situatë që e kemi përpara. Nuk e tolerojmë dhunën dhe pikë. Dhunën nuk mund ta tolerojmë dhe nuk do ta tolerojmë", ka theksuar Ristuccia për "RTK".

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka caktuar 18 dhjetorin datë të mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetarë të komunave në veri.

Katër komunat e banuara me shumicë serbe, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan, janë pa kryetarë që nga 5 nëntori.

Kryetarët e komunave, të nacionalitetit serb, dhanë dorëheqje në shenjë kundërshtimi ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për ta nisur procesin për regjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe.

Njohësi i çështjeve të sigurisë në Kosovë, Nuredin Ibishi, ka thënë se incidentet në veri janë shqetësuese dhe prishin qetësinë publike. "Kështu që institucionet e Kosovës, në këtë

KDI: Zero raste të sinjalizimit brenda institucioneve të drejtësisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar të enjten raportin "(Mos)Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në institucionet e sistemit të drejtësisë".

Ky është vetëm raporti i parë në serinë e raporteve të ngjashme që trajtojnë se sa po zbatohet ky ligj në institucionet publike dhe ato private të Kosovës.

Sinjalizimi është mjet i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, sepse i inkurajon qytetarët të shpalosin informacione ose keqpërdorime që ndodhin në vendin e tyre të punës e të cilat e cenojnë interesin publik. Por, pavarësisht punës së mirë që është bërë me miratimin e këtij ligji katër vjet më parë, institucionet publike e private në përgjithësi kanë bërë

shumë pak për zbatimin e tij dhe promovimin e sinjalizimit në përgjithësi.

Në këtë drejtim, institucionet e drejtësisë, prokuroritë dhe gjykatat, vetëm gjatë këtij viti kanë bërë hapat e parë në zbatimin e këtij ligji.

Analiza e KDI-së, e bazuar në intervista direkte me zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në institucionet e drejtësisë, argumenton se 90 për qind e këtyre institucioneve deri para gjashtë muajve ende nuk i kishin caktuar zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në institucionet e tyre si dhe nuk kishin publikuar kontaktet e tyre në uebfaqe. Këto zvarritje, së bashku me mungesën e trajnimeve adekuate për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim, kishin bërë që informatat dhe procedurat e sinjalizimit të mos arrinin të shtriheshin të personeli. Për më tepër, jo të gjitha institucionet

garantojnë kushte teknike për raportimin e rasteve ose sinjalizimin brenda hapësirave të tyre.

Albesa Humolli, zyrtare ligjore në KDI, ka theksuar që "çaktimi i zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim në disa prokurori në fakt ka ndodhur vetëm pasi KDI-ja, përmes kërkesës për qasje në informata, ka kërkuar nga këto institucione kontaktet e këtyre zyrtarëve, të dhëna këto që mungonin nëpër uebfaqet e disa prokurorive".

Ndërsa Gzime Hashani, zyrtare ligjore në KDI, ka potencuar se, "përkundër që Kosova ka një kornizë të konsoliduar ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve, brenda institucioneve të drejtësisë, deri më tani nuk është raportuar asnjë rast i vetëm i sinjalizimit".

Edhe institucionet që kanë për obligim monitorimin e zbatimit të këtij ligji, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në

institucionet publike) dhe Inspektorati i Punës (në institucionet private), kanë deklaruar se nuk kanë kapacitete të mjaftueshme as njerëzore dhe as financiare për të mbajtur trajnime të vazhdueshme për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim. Yll Buleshkaj, drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ka vlerësuar se ka munguar informimi i institucioneve për obligimet shtesë që burojnë nga legjislacioni lidhur me sinjalizimin. Duke folur për rëndësinë e ligjit, Buleshkaj ka thënë se nga viti i ardhshëm Agjencia do të zhvillojë trajnime për zyrtarët për sinjalizim si dhe fushata për vetëdijesim të qytetarëve.

Gjithashtu, u nënvizua nevoja për përmbylljen e procesit të hartimit të udhëzuesve përkatës që do të ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të sinjalizimit.

Në anën tjetër, edhe përfaqësuesit

e institucioneve të drejtësisë potencuan nevojën për më shumë trajnime jo vetëm të zyrtarëve për sinjalizim, por edhe stafit që mund të jenë potencialisht sinjalizues.

KDI-ja kërkon nga institucionet e drejtësisë, por edhe institucionet e tjera publike e private, që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të garantuar zbatim të plotë të ligjit për mbrojtje të sinjalizuesve. APK-së dhe MD-së kërkojnë të nxirren sa më shpejt udhëzuesit administrativë, që do t'ua lehtësojnë punën zyrtarëve përgjegjës për trajtimin efektiv dhe profesional të rasteve të sinjalizimit.

KDI-ja, po ashtu, i inkurajon punonjësit në sektorin publik e privat të kontribuojnë në kulturën kundër-korrupsionit duke përdorur sinjalizimin si mjet, por edhe si vlerë për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik.



rast edhe Këshilli i Sigurisë i Kosovës, duhet ta vlerësojnë gjendjen e sigurisë. Më pas, gjendja duhet t'i raportohet kryeministrit të Kosovës [Albin Kurti], në mënyrë që ai të vendosë se si do të veprojnë me zgjedhjet", ka thënë Ibishi.

Edhe sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile që monitorojnë zgjedhjet në Kosovë, procesi në veri duhet të shtyhet për një afat të pacaktuar.

Demokracia në Veprim (DnV) ka theksuar se që nga shpallja e datës së zgjedhjeve në katër komunat veriore nga presidentja e vendit, si rezultat i dorëheqjeve të kryetarëve të komunave në

veri të Kosovës, procesi i organizimit të këtyre zgjedhjeve është përcjellë me probleme të shumta. "Procesi është përcjellë nga bojkotimi i garës zgjedhore nga kandidatët e komunitetit serb që, në fakt, përbën shumicën absolute të popullsisë në këto komuna. Dorëheqjet e zyrtarëve përkatës zgjedhorë të këtyre komunave e kanë vështirësuar organizimin adekuat të këtyre zgjedhjeve, ndërsa rastet e djeshme të incidenteve dhe dhunës në atë pjesë kanë pamundësuar vazhdimin e përgatitjeve për administrimin e procesit zgjedhor", thuhet në reagimin e DnV-së.

DnV rikujton që ndër parimet kryesore të zgjedhjeve është 'votimi i lirë'. "Zhvillimi i të gjitha procedurave nën forca të shumta të sigurisë, si dhe nën kërcënim direkt të jetës së zyrtarëve zgjedhorë, por edhe qytetarëve dhe kandidatëve, bie ndesh me këtë parim. Kësisoj, është e qartë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka pothuajse të pamundur që t'i realizojë operacionet përkatëse zgjedhore për mbajtjen e rregullt dhe normale të këtyre zgjedhjeve. Madje KQZ-ja e ka pasur të pamundur që një gjë të tillë ta bëjë edhe me asistencën e Policisë. Bazuar në këtë situatë,

është vështirë e besueshme që do të mund të garantohet siguri në këto komuna për qindra persona të angazhuar si staf zgjedhor në ditën e zgjedhjeve, si dhe mijëra qytetarë me të drejtë vote. Për më tepër, probleme mund të ketë edhe me hapjen e qendrave të votimit", ka theksuar DnV-ja, duke shtuar tutje se në rrethanat aktuale të mungesës së sigurisë për stafin zgjedhor, mungesën e kandidatëve të komunitetit serb në garë, si dhe gjasave të pakta për pjesëmarrje të qytetarëve në zgjedhje, DnV kërkon nga presidentja e vendit që t'i iniciojë konsultimet me aktorët relevantë për t'i shtyrë zgjedhjet në katër

komunat veriore.

Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se në veri nuk ka kushte të mbahen zgjedhjet. "KMDLNj vlerëson se nuk ka kushte elementare të mbahen zgjedhjet e shpallura nga presidentja e Kosovës. Raportet nga KMDLNj në Mitrovicë rekomandojnë që këto zgjedhje të mos mbahen dhe të shtyhen për një kohë më të përshtatshme, aq më parë që askush nuk mund të garantojë sigurinë për votuesit sikur edhe vendet ku duhet të mbahen këto zgjedhje", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Humbjet në rrjetin elektroenergjetik të Kosovës bien në 15.96 për qind

PRISHTINË, 8 DHJETOR - "Luftimi i keqpërdorimeve në rrjetin elektrik është mision ditor i kompanisë. Përkushtimi i lartë, profesionalizmi dhe mobilizimi i më shumë se 50 ekipeve në baza ditore në tërë Kosovën, ka sjellë rezultat në uljen e humbjeve në 15.96 për qind", ka njoftuar KEDS-i. Sipas kësaj kompanie, këto të dhëna bazohen në raportin e fundit të tetorit të këtij viti, sipas të cilit, nënkuptohet se nga viti 2013, sa ishin mbi 31

për qind ato, janë minimizuar në gati 50 për qind. "Ekipet tona janë të pajisura me mjetet më moderne për identifikimin e vjedhjeve të energjisë elektrike dhe arrijnë t'i zbulojnë edhe format më të sofistikuar. Pra, askush nuk mund t'i ikë regjistrimit të kilovatëve të shpenzuar, prandaj konsumatorët nuk duhet të jenë pre e joshjeve të ndryshme nga individë të papërgjegjshëm. Forma e vetme ku ata që furnizohen

me energji elektrike nuk do të kenë asnjë telashe është forma e ligjshme, përkatësisht duke regjistruar secilin kilovat përmes njehsorit që e vendos KEDS-i. Rastet e devijimit nga ligjshmëria janë duke hasur në forcën e ligjit dhe duke marrë përgjigjen e merituar. Rastet e keqpërdorimeve dorëzohen në departamentin përkatës të KEDS-it, prej ku parapërgatiten për procedim të mëtutjeshëm në gjykatat e Kosovës", ka njoftuar KEDS-i.



Shtetit i zhduken mostrat e Astrit Deharit nga laboratorit



PRISHTINË, 8 DHJETOR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije të enjten, në një konferencë për medie, se janë zhdukur mostrat e Astrit Deharit nga laboratorit i toksikologjisë, aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, i cili u gjet i vdekur në qelinë e burgut në Prizren më 5 nëntor të vitit 2016. Për Haxhiun ky akt, përveçse është i rëndë, është edhe kriminal. "Për këtë arsye

mbrëmë e kam njoftuar Kryeprokurorin e Shtetit, Besim Kelmendi, si dhe drejtorin e Policisë, Fehmi Hoti. Sot në mëngjes kam vizituar Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe nga zyrtarët kompetentë jam njoftuar si në vijim. Në mbajtëset e epruvetave kanë qenë 15 epruveta me gjak, një epruvetë e urinës dhe një epruvetë e lukthit. Nga këto, instituti dy epruveta me gjak ia

ka dhënë institutit zviceran dhe një policisë për ADN. Sipas informacioneve, mungojnë 12 epruveta me gjak, një e urinës dhe një e lukthit", ka shtuar ajo. Sipas Haxhiut, në vendin ku ruhen epruvetat kanë qasje vetëm tre persona, të cilët tashmë janë lajmëruar në prokurori dhe polici. "Unë i di emrat e personave të cilët kanë qasje në këtë institucion në Departamentin e Laboratorit të

Toksikologjisë, por unë nuk mund t'i them, pasi që tashmë emrat e tyre i dinë edhe policia edhe prokuroria". Akti në fjalë, sipas pretendimeve të Haxhiut, ka një motiv të dëmtojë edhe më tej procesin në rastin e Astrit Deharit. "Prej gjashtë vjetësh të gjitha të dhënat, provat, dëshmitarët dhe çdo rrethanë e faktor është synuar të shtrembërohet, zhduket apo të

eliminohet. Ky akt i rëndë është vërejtur dhe gjatë mbartjes së monstrave nga frigoriferët e vjetër në ata të rinj, por jam e bindur që ka qenë çështje kohe që ata që kanë orkestruar do ta plasnin si një veprim dëmtues të procesit në përgjithësi", ka thënë ajo. Ministrja Haxhiu ka siguruar që autorët e këtij akti do të gjenden dhe rasti do të zbardhet.

Në Rahovec nis rrënimi i objekteve pa leje

RAHOVEC, 8 DHJETOR - Drejtoria për Punë Inspektuese në komunën e Rahovecit, pas përfundimit të të gjitha procedurave të parapara ligjore, ka bërë rrënimin e dy objekteve të cilat kishin filluar të ndërtohen pa leje të organit kompetent komunal,

saktësisht Drejtorisë së Urbanizmit. Drejtoria për Punë Inspektuese me këtë rast u bën thirrje të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit që të përmbahen dhe të mos fillojnë asnjë lloj pune në fushën e ndërtimit pa u pajisur

paraprakisht me leje të ndërtimit. "Në të kundërtën, ndryshe nga vullneti dhe qasja aktuale e qeverisjes së komunës, jemi të detyruar të ndërmarrim masa të ngjashme rrënimi, të rënda e të kushtueshme për të gjithë", ka njoftuar komuna e Rahovecit.



Ujësjetësi "Prishtina" fillon t'i shkyçë borxhlinjtë

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Ujësjetësi i Prishtinës ka njoftuar se i janë hapur të gjitha rrugët ligjore që nga 8 dhjetori të fillojë shkyçjen e të gjithë konsumatorëve borxhlinj të shërbimeve të ujit. "Meqenëse Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë lehtësimin e masave epidemiologjike nga Covid-

19, konsiderohet se situata në Kosovë për sa i përket rrezikut nga pandemia është reduktuar dhe se aktivitetet shoqërore dhe institucionale i janë kthyer normalitetit sikur në kohën e para pandemisë. Bazuar në vendimin e ARRU-së, Ujësjetësit të Prishtinës i janë hapur të gjitha rrugët

ligjore që nga sot të fillojë shkyçjen e të gjithë konsumatorëve borxhlinj të shërbimeve të ujit. Pra, përveç bizneseve dhe institucioneve, do të shkyçen nga shërbimet e ujit edhe konsumatorët shtëpiakë/individualë", ka njoftuar Kompania Rajonale e Ujësjetësit "Prishtina".



Paralajmërohet rritja e çmimit edhe për grumbullimin e bërllokut

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Asociacioni i Kompanive Publike për Menaxhim të Mbeturinave "Pamkos" ka vlerësuar nevojën e rritjes së tarifës së grumbullimit të mbeturinave në nivel vendi. "Referuar situatës së ngritjes së çmimeve dhe vlerësimeve financiare në ndërmarrjet publike të shërbimit të mbeturinave, kompanitë në fjalë po kalojnë situatë të rëndë financiare duke marrë parasysh rritjen e përgjithshme të çmimeve në të gjithë sektorët dhe respektivisht shpenzimet operative si pasojë e rritjes së çmimeve të lëndëve djegëse, si dhe rritjen e tarifës së deponimit të mbeturinave sipas vendimit të Ministrisë së Ekonomisë me dt. 02.12.2022 për rritjen e tarifës së deponimit të mbeturinave në vlerë rreth 37 për qind mbi tarifën aktuale për vitin 2023 (ose 2 euro në ton për mbeturinë) dhe me rritje progresive për secilin vit pasues sipas njoftimit prej qeverisë", ka njoftuar "Pamkos".

Sipas "Pamkos", ngritja e çmimeve dhe tarifave që parashihen të aplikohen për deponimin e mbeturinave ndikojnë drejtpërsëdrejti në qëndrueshmërinë financiare të kompanive publike të mbeturinave si dhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarë. "Njëherësh, duke marrë parasysh vendimin e Ministrisë së Ekonomisë për rritjen e tarifës së deponimit të mbeturinave dhe rritjen e çmimeve për lëndë djegëse dhe në kategori të caktuara, kjo situatë i pozicionon



të gjitha ndërmarrjet publike të mbeturinave në nivel vendi në vështirësi financiare që nënkupton kufizimin e plotë të ndërmarrjes për të realizuar operim të sigurt në bartje të mbeturinave, investime në ndërmarrje, mirëmbajtje efektive të aseteve operative të ndërmarrjes si dhe rrezikon punën e të gjithë punëtorëve që punojnë në këto ndërmarrje", theksohet në njoftim.

Gjithashtu, "Pamkos" thekson se si rezultat i borxheve të

akumuluar që qytetarët kanë ndaj KRM-ve, kompanitë po përballen me gjendje jo të mirë financiare, për më tepër, me sfida në operim dhe mbulimin e të gjitha kostove për kryerjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe pagesave për deponimin apo mirëmbajtjen e deponive komunale të cilat penalizojnë funksionimin e rregullt të tyre. "Andaj, si Asociacion i Kompanive Publike për Menaxhimin e Mbeturinave, u bëhet thirrje komunave të

Kosovës që t'i përkrahin financiarisht kompanitë e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave si dhe t'i ndryshojnë tarifën e shërbimit të mbeturinave. Ndërmarrjet e mbeturinave aktualisht operojnë me statutin për ndërmarrje publike me vetëfinancim dhe kjo situatë e krijuar me rritje enorme të çmimeve të lëndës djegëse dhe rritje të tarifës së deponimit të mbeturinave në deponi sipas vendimit të qeverisë, adresojnë nevojën emergjente prej nivelit

lokal që ta nisn ndryshimin e tarifës për grumbullimin e mbeturinave apo të subvencionojnë në tërësi diferencën e rritjes së shpenzimeve, me qëllim moscenimin financiar të kompanisë që afekton me pasojë të mosoperimit efikas, ndikim në mjedis dhe mirëqenien e qytetarëve", ka theksuar drejtoresha ekzekutive e "Pamkos", Merlina Beu-Muçaj, në komunikatën drejtuar kryetarëve të komunave dhe medieve.

Dogana sekuestron 42 mijë litra alkool

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Dogana e Kosovës ka realizuar një kontroll rutinor në një dyqan të pijeve alkoolike në fshatin Hoçë e Madhe, komuna e Rahovecit.

Zyrtarët doganorë kanë gjetur se, përveç dyqanit, personi përgjegjës operon edhe me veprimtarinë e prodhimit të pijeve alkoolike pa autorizim nga Dogana e Kosovës, veprim ky që është në kundërshtim me normat përkatëse të Kodit Doganor

dhe Akcizave.

Sipas Doganës, personi e nuk ka të regjistruar aktivitetin as si biznes në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve dhe nuk përfill kërkesat e raportimit të entit përkatës për mbikëqyrje të prodhimtarisë së verërave. "Duke qenë se natyra e këtij veprimi të dyshuar përbën vepër penale, Dogana ka njoftuar prokurorin e shtetit për veprimet e mëtejme. Gjatë kontrollit janë hasur produkte

të gatshme me përmbajtje alkooli në sasi prej 42 mijë litrash. Personi në fjalë ka vepruar krejtësisht në shpërfillje të rregullimit ligjor dhe i ka bërë dëm buxhetit në vlerë rreth 38 mijë euro vetëm për pjesën e detyrimeve për stokun e hasur gjatë kontrollit. Ky aktivitet afarist i paregjistruar që nuk u nënshtrohet as kontrolleve sanitare e higjienike, përbën rrezik edhe për shëndetin e konsumatorit", ka njoftuar Dogana.



Kosova përfiton grante nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor në vlerë prej 57.6 milionë eurosh



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

BRUKSEL, 8 DHJETOR - Bordi Operacional i Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor (WBIF) ka miratuar tri aplikime për fonde të Republikës së Kosovës, duke mundësuar përfitimin e granteve në vlerën totale prej 57.6 milionë eurove. Këtu përfshihet granti për përgatitjen e projektit për banimin social në vlerë prej 2.08 milionë eurosh, që do të shfrytëzohet për përgatitjen e investimeve që kanë vlerën totale prej 47.5 milionë eurosh. Gjithashtu, granti investues për parkun solar në KEK, në vlerë 33.07 milionë euro, si pjesë e investimeve që kanë vlerën totale prej 103.33 milionë eurosh.

Granti i tretë është ai investues për ngrohjen qendrore në kryeqytet në vlerë prej 22.47 milionë

eurosh si pjesë e investimeve që në total kanë vlerën 76.368 milionë euro. Projektet për të cilat janë përfituar grantet do të realizohen në kombinim me huat që do të merren nga bankat përkrahëse për këto projekte, sikurse Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (CEB), Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI). Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor (WBIF) është një iniciativë e përbashkët e BE-së, institucioneve financiare dhe donatorëve dypalësh, që synon ta rrisë bashkëpunimin dhe bashkërendimin për sa iu përket investimeve që kanë për synim zhvillimin socio-ekonomik dhe kontribuimin në perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Kosova merr edhe 100 milionë euro fonde nga BE-ja dhe Gjermania

Bashkimi Evropian, Gjermania dhe Qeveria e Kosovës nënshkruan një ditë më parë në Prishtinë dy marrëveshje të mëdha financiare që do t'i mundësojnë Kosovës të marrë më shumë se 100 milionë euro për zbatimin e projekteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe menaxhimit të mbeturinave të ngurta në tërë Kosovën nga viti 2023 deri në vitin 2027.

Të dy projektet, të cilat tregojnë solidaritetin e fortë të BE-së dhe shteteve anëtare me Kosovën, do të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe do ta rritin përputhshmërinë e Kosovës me standardet mjedisore të BE-së si një nga kërkesat e anëtarësimit në BE.

Qëllimi është të zgjidhen problemet akute të mbeturinave në komunat e Kosovës dhe të ndihmohet për krijimin e kushteve më të sigurta dhe më të mira të jetesës.

Projekti i trajtimit të ujërave të zeza, i zbatuar në rajonin e Prishtinës, do ta përfshijë ndërtimin e linjave të reja kryesore të kanalizimit nga Prishtina në Fushë-Kosovë dhe Obiliq dhe në drejtim të Graçanicës dhe Jugperëndimit, si dhe rehabilitimin e rrjeteve rajonale të kanalizimeve dhe lidhjeve të shtëpive dhe të sistemit të ndarjes së ujërave të stuhishme.

Ky projekt do ta plotësojë ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza, që do të financohet nga Franca, duke e bërë këtë përpjekje të përbashkët të BE-së, Gjermanisë dhe Francës, investimin më të madh në këtë

sektor në Kosovë. Gjermania do të sigurojë 48.8 milionë dhe BE-ja 20 milionë euro për projektin e ujërave të zeza, ndërsa komuna e Prishtinës dhe e Fushë-Kosovës do ta bashkëfinancojnë projektin me 9 dhe 2 milionë euro.

Projekti për menaxhimin e mbeturinave të ngurta do të zbatohet në komunën e Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit, Ferizajt, Podujevës dhe Pejës, dhe do të përfshijë ndërtimin, zgjerimin dhe rehabilitimin e deponive dhe stacioneve të transferimit të mbeturinave të ngurta. Për këtë projekt Gjermania do të sigurojë 20 milionë dhe BE-ja gjithsej deri në 24 milionë euro, ndërsa Qeveria e Kosovës do të kontribuojë me 8 milionë euro dhe komuna e Pejës me 3 milionë euro të tjera.

BE-ja dhe shtetet e saj anëtare mbeten ofruesit më të mëdhenj të ndihmës financiare për Kosovën.

Del në konsultim publik Ligji për burimet e ripërtërishme të energjisë

Prishtinë, 8 dhjetor - Ministria e Ekonomisë ka njoftuar se në platformën e konsultimeve publike më 7 dhjetor ka dalë në konsultim publik Ligji për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE).

Ligji i BRE-ve përcakton promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë në Republikën e Kosovës me qëllim të rritjes së përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe bashkëprodhimin në sektorin e energjisë elektrike, ngrohjes dhe ftohjes dhe sektorin e transportit,

me qëllim të përmbushjes së nevojave për energji, rritjes së sigurisë së furnizimit, përmirësoi mbrojtjen e mjedisit, si dhe ofrimin të përfitimeve sociale dhe shëndetësore dhe promovimit të mundësive të barabarta punësimi në sektor të energjisë. Përmes këtij ligji do të mundësohet zhvillimi i kapaciteteve të BRE-së me procedurë konkurruese, transparente dhe jodiskriminuese.

Ky ligj pjesërisht transponon Direktivën (BE) 2018/2001 për Promovimin e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e

Ripërtërishme, miratuar me Vendimin (2021/14/MC-EnC) të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Ministria e Ekonomisë e vlerëson shumë konsultimin me palët e interesit. "Prandaj, kontributi juaj paraprak me shkrim do të jetë shumë domethënës dhe përmbytësor. Ministria e Ekonomisë mbetet e përkushtuar që kontributin tuaj përmes komenteve dhe sugjerimeve të ofruara t'i përfshijë brenda ligjit. Afati përfundimtar i dorëzimit të kontributit me shkrim në kuadër të procesit të konsultimit



të Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë është

15 ditë pune nga momenti i publikimit", ka njoftuar Ministria e Ekonomisë.

Dëshmorët nga Maqedonia të rënë në luftën për çlirimin e Kosovës



Doc. dr. Minir ADEMI

Në rrugën e gjatë të lëvizjes për çlirim, bashkim dhe përparim të kombit shqiptar, gjatë shekujve, vend meritore zënë veprimtarët dhe personalitetet, luftëtarët e lirisë të rreshtuar në radhët e UÇK-së. Një rëndësi të veçantë paraqesin edhe luftëtarët e lirisë nga trevat e tjera shqiptare të cilët ishin tepër të rëndësishëm dhe të nevojshëm në ndihmën e dhënë për lirinë e Kosovës.[1] Në kuadër të shumë personaliteteve dhe luftëtarëve të lirisë, ishin edhe 10 dëshmorët e rënë në luftën e Kosovës nga Maqedonia, të cilët sakrifkuan edhe jetën për lirinë e Kosovës. Ata janë: Beqir Limani, Kërçovë, Ismet Jashari, Kumanovë, Safet Ajeti, Kumanovë, Ismet Mustafa, Kumanovë, Mujdin Aliu – Tetovë, Aliriza Selmani, Tetovë, Remzi Xhaferi, Shkup, Tahir Osmani, Shkup, Shabi Kajolli, Shkup dhe Zekir Dardhishta, Shkup.



BEQIR LIMANI – BEQA (22.1.1952-18.9.1998)

Beqir Limani, lindur më 22.01.1952 në Kërçovë, nga babai Shukriu dhe nëna Nazife, kishin 8 fëmijë, 7 djem

e një vajzë: Tasimin, Milaimin, Aliun, Beqirin, Habibin, Muhametin, Xhavitin dhe vajzën Alije. Beqir Limani kishte katër djem: Fadilin, Fatmirin, Dashmirin dhe Hashimin. Ai nga familja e të parëve ishte i frymëzuar nga jehona e së kaluarës së lavdishme, nga kënga e konakut për trimat që u bënë ballë hordhive nga trimëria e kaçakëve të pamposhtur të kësaj ane, të cilët më pas edhe vetë u këndonte këngë. Beqir Limani qysh i ri filloi veprimtarinë e tij si aktivist kundër diktaturës komuniste jugosllave. Në vitet '70 dhe fillimvitet '80, Beqir Limani i bashkëngjitet Lëvizjes Popullore të Kosovës për liri. Dëshira për ta mbajtur gjallë shpresën, ndjenja për ta kultivuar atdhedashurinë edhe te gjeneratat e reja, ecte krenar përpara. Kjo mbase ishte arsyeja që ra në sy të atyre që dinin të bënin vetëm lajka. Atij i vinin prita gjithandaj, mirëpo ai nuk ndalej, ecte përpara bashkë me idealin e pamposhtur.

Beqir Limani ka qenë përgjegjës për Zonën e Dytë Operative të Iliridës. Një ditë shtatori nuk ishte si zakonisht. Ajo ditë nuk ishte si ditët e tjera. Atë e kishin rrethuar nga të katër anët. Mirëpo, Beqir Limani nuk dorëzohej. Si të dorëzohej në shtëpinë e tij. Ndonëse djalini ia kishin marrë peng, ai nuk dorëzohej, "patjetër duhet të ngadhënjej", thoshte. Më 18 shtator të vitit 1998 policia rrethoi shtëpinë e Beqir Limanit, me një urdhër arresti, por hasi në rezistencën e tij dhe papritmas vërshëllenin plumbat. Një sy i keq e kishte marrë në shenjë dhe e kishte qëlluar për

vdekje. Para se të jepte frymën e fundit kishte lënë porosinë: "Rrugën që nisa unë ta vazhdoni, që ta gëzojnë nipat e mbesat. Rruga e lirisë të vazhdohet, rruga" ... dhe kishte mbyllur sytë. Sot figura e Beqir Limanit qëndron e lartësuar përkrah figurave të njohura të popullit si Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Me fillimin e luftës në Maqedoni në vitin 2001 dhe me daljen në skenë të emblemës së UÇK-së, brigadës së parë iu vu emri "Brigada 111 Beqir Limani". Beqir Limani, me nr. prot. D/2992, merr certifikatën e dëshmorit të Kosovës.[2]



ISMET JASHARI – KUMANOVA (16.4.1967 – 25.8. 1988)

Ismeti lindi më 16 prill 1967 në fshatin Orizare të komunës së Likovës – Kumanovës. Ishte i biri i Jasharit dhe nënës Nurie. Ismeti rrjedh nga një familje me vlera atdhetare. Për shkak të ndjekjeve dhe presionit të vazhdueshëm të pushtetit jugosllav, ashtu si shumë veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare, edhe Ismet Jashari detyrohet të emigrojë në Zvicër.[3] Edhe aty nuk e ndali aktivitetin dhe angazhimin atdhetar. Asokohe ishte

në kontakt të vazhdueshëm me vëllezërit, Muratin dhe Xhemailin, si dhe me shumë bashkëveprimtarë, të cilët zhvillonin aktivitetet çlirimtar. Ai së bashku me veprimtarë të tjerë nuk reshti kurrë për krijimin e kushteve për luftë të armatosur kundër pushtuesve të trojeve etnike. Ismeti ishte ndër të parët që mori pjesë në themelimin e fondit "Vendlindja thërret", i cili u bë bazë kryesore e logjistikës dhe e financimit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjithashtu, menjëherë pasi filluan luftimet midis UÇK-së dhe ushtrisë e policisë serbe, ai vendosi të vinte në Kosovë e të merrte pjesë në frontin e luftës.

Pas ngjarjes epokale në Prekaz më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, atdhetari i përkushtuar i luftës çlirimtare, Ismet Jashari, nuk kishte hamendje që t'i fillonte përgatitjet për të hyrë në Kosovë. Kështu, më 11 mars 1998, ai, bashkë me Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin, Mirush Dakën, Bekim Berishën, Agim Bajramin, Fatmir Limajn, Haxhi Shalën e të tjerë, futet në zonat ku po vepronte Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe vendoset në Likoc të Drenicës, ku asokohe ndodhej baza më e rëndësishme e saj.

Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ismet Jashari u ngarkua me detyrë ushtarake në Zonën e Llapushës, me qëllim të zgjerimit dhe konsolidimit të radhëve të ushtrisë çlirimtare.

Që në mars të vitit 1998, Ismet Jashari me bashkëluftëtarët e tij, Fatmir Limajn, Haxhi Shalën,

Sadik Shalën e të tjerë, formojnë njësitin ushtarak "Çeliku" me bazë në fshatin Kleçkë. Që në fillim të përfshirjes së tij në luftën e Kosovës, për shkak të konspiracionit, Ismetin bashkëluftëtarët e thërrisnin me emrin "Kumanova". Ismeti me bashkëveprimtarë ishin luftëtarët e lirisë që rrezatonin shpresë dhe frymëzim për popullatën civile dhe për të gjithë ushtarët e lirisë. Rrugën e lavdishme të Ismet Jasharit e ndoqën trimat luftëtarë nga të gjitha anët e trojeve etnike të cilët me zjarrin dhe prushin luftarak të komandant "Kumanovës" ishin gjithmonë drejt fitores.[4]

Në prill të vitit 1998, Ismet Jashari, i ngarkuar me detyrë ushtarake, ndodhej në Dukagjin. Gjatë kthimit për në Kleçkë ra në pusi të forcave serbe, te vendi i quajtur "Guri i Zi", në mes të fshatrave Volljak dhe Çupevë të Klinës. Këtu ai plagoset në të dyja këmbët. Kur luftëtarët e lirisë arritën ta merrnin nën kontrollin e tyre grykën legjendare të Llapushnikut, më 9 maj të vitit 1998, Ismet Jashari, ende pa u shëruar sa duhet, mori pjesë aktive në barrikadimin e kësaj gryke, e cila u bë barrierë e pathyeshme për forcat armike deri më 27 korrik të po atij viti.

Pas marrjes së asaj pike tejet të rëndësishme strategjike, Ismet Jashari me bashkëluftëtarët e tij iu afrohet pikave të tjera po aq me rëndësi: në Qafë të Dulës dhe në Grykë të Carralevës. Prej fillimit të majit e deri në mbarim të gushtit të vitit 1998, Ismet Jashari, komandant "Kumanova", Fatmir Limaj, komandant "Çeliku", Haxhi Shala, komandant "Topi", Shukri Buja,

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sot zhvillohen çerekfinalet e para Kroaci - Brazil dhe Holandë - Argjentinë

"Epoka e re"

DOHA, 8 DHJETOR - Brazili do të bëjë përpjekje të mbajë gjalla shpresat për ta fituar Kupën e gjashtë në histori, por fillimisht duhet ta eliminojë Kroacinë në çerekfinale të Kupës së Botës. Brazili dhe Kroacia përballën sot (e premte) nga ora 16:00 në "Education City". "Selecao" në 16 e finales e mposhti Korenë e Jugut, derisa kroatët e mposhtën Japoninë pas penalltive. Kroacia ka rezultate të mira, pasi janë të pamposhtur në dhjetë ndeshjet e tyre të fundit ndërkombëtare dhe kanë humbur vetëm një nga njëzet ndeshjet e fundit në të gjitha garat që nga "Euro 2020", por kjo ecuri mbresëlënëse do të testohet nga një kombëtare e fortë siç është Brazili. "Selecao" ka vetëbesim të madh momentalisht dhe po përgatitet për çerekfinalen e shtatë radhazi të Kupës së Botës, por do të jetë i kujdesshëm ndaj rekordit të fundit në këtë fazë të

Formacionet e mundshme:

Kroacia: Livaković; Juranović, Lovren, Gvardiol, Sosa; Kovačić, Brozović, Modrić; Kramarić, Petković, Perišić.

Brazili: Alisson; Militao, Thiago Silva, Marquinhos, Danilo; Casemiro, Paqueta; Raphinha, Neymar, Vinicius Jr, Richarlison.

Holanda: Noppert; Timber, Van Dijk, Ake; Dumfries, De Jong, De Roon, Blind; Klaassen; Gakpo, Depay.

Argjentina: Martinez; Molina, Romero, Otamendi, Acuna; Fernandez, De Paul, Mac Allister; Di Maria, Messi, Alvarez.

kompeticionit. Brazili është eliminuar në fazën çerekfinale në tri nga katër Kupat e Botës, duke humbur nga treshja evropiane Francën, Holandën dhe Belgjikën më 2006, 2010 dhe 2018. Që kur mundi Gjermaninë 2-0 në finalen e Kupës së Botës 2002, Brazili ka humbur secilën nga pesë ndeshjet e fundit me



eliminim direkt kundër kombeve evropiane në këtë kompeticion. Megjithatë, "Selecao" nuk ka humbur kurrë në katër takimet e mëparshme me Kroacinë, ndërsa humbja 1-0 në fazën e grupeve ndaj Kamerunit javën e kaluar

është humbja e tij e vetme në nëntëmbëdhjetë ndeshjet e tyre të fundit ndërkombëtare. Ndërsa nga ora 20:00 zhvillohet përballja tjetër çerekfinale mes Holandës dhe Argjentinës. Skuadra përfaqësuese e drejtuar nga Luis

Van Gaal mposhti ShBA-në (3-1) për ta siguruar vendin e tyre në tetë të fundit, ndërsa kampionët e Amerikës së Jugut mundën Australinë (2-1) për t'i mbajtur gjallë shpresat e tyre për ta fituar Kupën e Botës.



U17 dhe U19 mësuan kundërshtarët e kualifikimeve për 'Euro 2024'

NION, 8 DHJETOR - Në selinë e UEFA-s në Nion të enjten është bërë tërheqja e shortit për kualifikimet e Kampionatit Evropian 2024 në grupmoshat nën 17 dhe nën 19 vjeç. Përfaqësuesja e Kosovës U17 është përfshirë në Grupin e 9, ku

bëjnë pjesë edhe Anglia, Kroacia dhe Ishujt Faroe. Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen në Kroaci më 3, 6 e 9 nëntor 2023. Ndërkaq, U19 bën pjesë në Grupin 7, ku janë përfshirë edhe Ukraina, Sllovakia dhe Malta. Kjo e fundit do të jetë nikoqire e mini-torneut

të këtij grupi, ndeshjet e të cilit zhvillohen më 15, 18 dhe 21 nëntor. Dy skuadrat e para në secilin grup do të kalojnë në raundin elitare së bashku me pesë skuadrat e vendit të tretë me bilancin më të mirë kundër dy të parave në grupet e tyre.

Daja: Nuk jam kontaktuar nga FShF-ja

Suharekë, 8 dhjetor - Trajneri i Ballkanit, Ilir Daja, ka mohuar të jetë kontaktuar nga Federata Shqiptare e Futbollit për ta marrë drejtimin e skuadrës kuq e zi. Megjithatë, Daja nuk e ka mohuar se do të refuzonte një ftesë në rast se ajo të vinte pasi, sipas tij,

drejtimi i një ekipi kombëtar është ëndërr. "Unë mendoj që kulmi i çdo trajneri është ta marrë drejtimin e ekipit kombëtar, por unë jam në kontratë me Ballkanin dhe nuk kam pasur kontakt të drejtpërdrejtë me askënd. Nëse unë jam kandidat potencial për

t'u bërë trajner i Shqipërisë, së pari duhet të flas me drejtuesit e Ballkanit, pasi kam edhe dy vjet kontratë këtu. Vetë personalisht nuk jam kontaktuar nga drejtuesit e Federatës Shqiptare të Futbollit", ka thënë trajneri Daja për "Kanal 10".



Spanja shkarkon trajnerin Enrique

MADRID, 8 DHJETOR - Federata Mbretërore e Futbollit Spanjoll njoftoi për largimin e Luis Enrique nga pozita e trajnerit, të cilin e mban që nga viti 2018, kur pas Kupës së Botës në Rusi, ai pasoi Fernando Hierro, i

zgjedhur trajner i përkohshëm. Komunikimi zyrtar vjen as 48 orë pas eliminimit zhgënjyes spanjoll ndaj Marokut, me penallti, në 1/16 e Botërorit të Katarit. Vitin e kaluar, me rastin e "Euro 2020", Luis Enrique

udhëhoqi Spanjën deri në gjysmëfinale, ku edhe me penallti humbi nga Italia. Në total, Luis Enrique bëri 40 paraqitje si trajner, duke shtuar 23 fitore, 12 barazime dhe 5 humbje. Luis de la Fuente,

trajneri U21, duhet të jetë pasardhësi i tij në krye, në mënyrë që të fillojë përgatitjet për kualifikimin në Euro-2024 (Spanja është në Grupin A me Gjeorgjinë, Qipron, Skocinë dhe Norvegjinë).



PSG-ja nuk është e interesuar për Ronaldon

Paris, 8 dhjetor - Cristiano Ronaldo është futbollist pa kontratë dhe e ardhmja e tij ende mbetet e paqartë. Presidenti i PSG-së, Nasser Al Khelaifi, ka mohuar interesimin e skuadrës

franceze për pesë herë fituesin e "Topit të Artë". "Tre lojtarët që ne kemi [Lionel] Messi, Neymar dhe [Kyllian] Mbappe, është shumë e vështirë, por unë i uroj gjithë të mirat atij. Ai është fantastik dhe ende

është një lojtar i mahnitshëm", ka thënë Al Khelaifi për "Sky Sports". Ronaldo përfundoi marrëveshjen me Manchester Unitedin, derisa interesim për shërbimet e tij ka shfaqur klubi nga Arabia Saudite, Al-

Nassr. Për këtë të fundit portugezi e ka mohuar mundësinë që t'i bashkëngjitet për faktin se synimi i tij është që ende të luajë në Evropë dhe Ligën e Kampionëve.



Flick, pasi i shpëton shkarkimit: Triumfojmë në 'Euro 2024'

BERLIN, 8 DHJETOR - "Mëkatet" e Gjermanisë në Botëror, eliminimin e turpshëm që në fazën e grupeve, i dyti radhazi, i "lau" të gjitha Oliver Bierhoff, pasi drejtuesit e Federatës së Futbollit vendosën ta konfirmojnë në stol Hansi Flick. "Jemi të gjithë të bindur se 'Euro 2024', që do të zhvillohet në vendin tonë, është një mundësi e shkëlqyer për futbollin gjerman. Objektivi ynë është ta transformojmë këtë turne në sukses sportiv. Kemi besim të plotë se Hansi Flick do ta dominojë në këtë sfidë me stafin e tij", thuhet në njoftimin e Federatës Gjermane.

Katër herë kampionët e Botës dështuan në Katar, por Flick e ka "brumin" për të ndërtuar një skuadër fituese, sigurisht është në garë me kohën për ta rikthyer Gjermaninë në nivele të larta.



"Unë dhe stafi im jemi besimplotë për Evropianin që do të zhvillohet në vendin tonë. Si skuadër mund të arrijmë shumë më shumë sesa bëmë në Katar. Aty humbëm një shans të mirë, por duhet të na

shërbejë si mësim. Dëshirojmë që e gjithë Gjermania të bashkohet me përfaqësuesen në 'Euro 2024', ka deklaruar Flick pas vendimit të Federatës për ta konfirmuar në krye të përfaqësueses.

Kampionët humbasin në sekondën e fundit

TORONTO, 8 DHJETOR - Nuk pati histori në ndeshjen ku Bostoni fitoi me rezultat 125-98 ndaj Phoenixit, sfidë që vuri përballë dy skuadrat që udhëheqin konferencat përkatëse. Skuadra e Celticsit dominoi në takim, duke u konfirmuar si skuadra më e mirë në NBA. Tatum e Brown, me nga 25 pikë secili, bënë dallimin në parket për Boston, ndërkohë që 48 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Humbet në sekondën e fundit



ekipi kampion i Golden States, që u mund 124-123 nga Utah Jazzi. Një sfidë e ekuilibruar deri në fund, ku për Warriorsin nuk mjaftuan 36 pikët e Poles. Për Jazz, 7 lojtarë realizuan mbi 10

pikë, duke bërë që kolektiviteti të triumfojë. Humbet edhe skuadra e Lakersave, që u mund me rezultat 126-113 nga Toronto, sfidë ku për miqtë munguan të gjithë titullarët.

Rezultatet

Orlando - Clippers	116-111
Brooklyn - Charlotte	122-116
New York - Atlanta	113-89
Toronto - Lakers	126-113
Chicago - Washington	115-111
Memphis - Oklahoma	123-102
Milwaukee - Sacramento	126-113
Minnesota - Indiana	121-115
New Orleans - Detroit	104-98
Utah Jazz - Golden S.	124-123
Phoenix - Boston	98-125

SHKURT

Elbasan Thaqi ndahet me Ferizajn

Largimet e futbollistëve nga skuadra e Ferizajt po vazhdojnë. Ky klub njoftoi se të enjten është larguar edhe mbrojtësi Elbasan Thaqi. Ky i fundit nuk ka qenë pjesë e Ferizajt në tre muajt e fundit për shkak të një vendimi të Komisionit Disiplinor. "FC Ferizaj njofton se edhe zyrtarisht nga dita e sotme i ka ndarë rrugët me qendërmbrojtësin Elbasan Thaqi. Thaqi tash e tre muaj nuk ka qenë pjesë e ekipit për shkak të një vendimi të Komisionit Disiplinor brenda klubit që e suspendoi qendërmbrojtësin Thaqi. Shëndet e suksese Elbasan Thaqi!", thuhet në njoftimin e Ferizajt.

KB Bashkimi arrin marrëveshje me ish-basketbollistin e NBA-s

KB Bashkimi ka arritur marrëveshje për transferimin e basketbollistit Samardo Anthony Samuels. Klubi prizrenas ka njoftuar në faqen zyrtare se marrëveshja me basketbollistin në fjalë është arritur. Xhamajkani Samardo Anthony Samuels ka një karrierë të bujshme. Ai ka luajtur edhe tek ekipi i NBA-s, Cleveland Cavaliers, gjatë sezoneve të vitit 2010 deri më 2013. "Të nderuar qytetarë të Prizrenit, të nderuar adhurues të basketbollit, kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se tashmë Klubi ynë ka arritur marrëveshje me një legjendë të basketbollit ndërkombëtar si Samardo Anthony Samuels. Një emër me karrierë të dëshmuar në çdo ligë pjesëmarrëse dhe në ato më të fortat botërore. Prania dhe përvoja e tij në ekipin tonë do të jetë një vlerë e shtuar duke e ngritur nivelin sportiv e basketbollistik. Mirë se vjen Samardo te familja jonë e bashkuar, Bashkimi!", thuhet në njoftimin zyrtar të Bashkimit.

Asllani: Nuk largohem nga Interi

Futbollisti Kristjan Asllani, në një intervistë për "La Gazzetta dello Sport", ka hedhur poshtë mundësinë e largimit nga Interi në afatin kalimtar të janarit. "A e kam kërkuar largimin në janar? Asnjëherë. Të gjitha zërat janë të rreme. Jam i lumtur që luaj për Interin dhe dua të qëndroj këtu. E bëra këtë zgjedhje dhe do ta bëja përsëri. Që në fillim e dija se çfarë më priste tek Interi. E di që është e vështirë të pozicionohesh si titullar në një ekip të madh, por unë nuk dorëzohem dhe dua të qëndroj këtu. Jam shumë i lumtur", ka thënë Asllani.

Ten Hag: Ronaldo ka ikur, është e kaluara

Cristiano Ronaldo është larguar nga Manchester Unitedi, kurse për herë të parë ka folur trajneri Erik Ten Hag. "Ai ka ikur dhe është e kaluara. Tani po shohim përpara dhe po shikojmë kah e ardhmja. Ne shikojmë dhe me lojtarët e futbollit është e qartë se kjo është gjëja e parë - aftësitë që ka një lojtar", ka thënë Ten Hag për MUTV në një kamp stërvitor në Spanjë. "Qenia njerëzore prapa është gjithashtu një faktor i rëndësishëm, por nuk mund ta nënvlerësosh këtë. Kemi nevojë për personazhet e duhura në dhomën e zhveshjes, jo vetëm nëse do të fitosh një lojë, por nëse do të fitosh trofe", ka shtuar Ten Hag.

Silva: Brazili nuk frikësohet nga askush

Brazili është kandidat për fitimin e Kupës së Botës, por rekordmenët e turneut më të rëndësishëm në futboll i pret një test i vështirë të premtën ndaj Kroacisë (16:00). Kapitëni i kombëtares "seleção", Thiago

Silva, u shpreh se ai dhe shokët e tij nuk kanë frikë asnjë kundërshtar. "Ne jemi të fortë në fushë, por edhe në kokat tona. Nuk ishte ndeshje e lehtë ajo ndaj Koresë së Jugut. Punuam shumë në lidhje me

përgatitjen e asaj ndeshjeje. Nuk mund të mos i respektonim koreanët. Para se të mendojmë për gjysmëfinalen e mundshme kundër Argentinës, ne duhet të fokusohemi te Kroacia. I respektojmë të gjithë, por nuk i

frikësohemi askujt. Duhet të vazhdojmë përpara me futbollin tonë guximtar dhe dëfryes", ka deklaruar Silva. "Neymari është i domosdoshëm për ne. Ai kaloi një javë të komplikuar dhe

zbriti në fushë me vetëm dy seanca stërvitore. Ai ka treguar se është 100 % i fokusuar te Kupa e Botës dhe se e dëshiron me çdo kusht fitoren finale", ka deklaruar qendërmbrojtësi brazilian.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "PHI BEAUTY VIBES" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810169294 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "PHI BEAUTY VIBES" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810169294 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "PHI BEAUTY VIBES" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810169294 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

LAJMËROJMË

Bashkëpronarit LATIF (RUSTEM) DESTASNI, nga Fshat Zojz – Prizren, edhe Qamil (Beqir) Krasniqi, si Blerësit potencial se, Bashkëpronarët Dragisha Mitrovci, si bashkëpronarë ligjor të ngastrave kadastrale me numër P-71813028-00292, që ka sipërfaqe të përgjithshme prej 3777 m² të gjitha në Zonën Kadastrale Zojz-Prizren, po i Sheshim - pjesët tona bashkëpronësore.

Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmërohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr. " Fehmi Lladrovci " nr.70 – Prizren.

Një herri informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 5.000 €, me para të gatshme-në kesh.

Telefoni kontaktues:+383·(0) 44/351-471

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kumrije Azemi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "28 Nëntori" Prishtinë.

- "Zone Projekt" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810038689.

- Zija R. Ramadani me nr. personal 1006027110 nga Lashtica shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik Prishtinë.

- Dion Ethem shpall të pavlefshme dëftesën e kl. njëmbëdhjetë të shkollës "Mileniumi i Tretë" Prishtinë.

- Hekuran Krasniqi nga Demjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. kongresi manastirit Demjan KK Gjakovë nga kl. I-V dhe nga kl. VI-IX.

- Kujtese Kokalla nga Cermjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Amet Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

- Kastriot Mucaj shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Elvis Susuri shpall të pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Eldina Bajsin shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Burim Fazliu (Krasniqi) shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.

- Andi Shefqeti shpall të pavlefshme diplomën dhe vërtetimin e lëshuar për gjendjen e notave dhe mungesave shmt "11 Marsi " Prizren.

- Redon Mazreku shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Edison Mazreku shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

- Albnor Ibrahim shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren

- Albina Dumnica B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330445842.

- Agron Merovci nga Vushtrria shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme Bujqësore tash "Avdyl Frashëri" drejtimi Veterinë.

- Sahit Kurhasku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. "Ali M. Hasi" Crmjan KK Gjakovë nga kl.I-VII.

- Avdullah Guta nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Artan Rrahmani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Auto Mekanik.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

